



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 73, Datë 13.03.2023

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “SUNPOWER 2017” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E  
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME  
KAPACITET TË INSTALUAR 2 MW, NË POVELÇË, BASHKIA FIER**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1, gërma “a” dhe nenit 13 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimit dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 13.03.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 134/8 prot., datë 09.03.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë “SUNPOWER 2017” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, në Povelçë, Bashkia Fier”,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 2, datë 10.01.2023 vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “SUNPOWER 2017” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në zonën e Povelçës, Bashkia Fier.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 11.01.2023 dhe 12.01.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 20.01.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e kësaj procedure u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Për shkak të kohës së pamjaftueshme për shqyrtimin e dokumentacionit plotësues të depozituar nga ana e shoqërisë, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 26, datë 09.02.2023, u vendos të zgjatej deri në 30 (tridhjetë) ditë afati për marrjen e vendimit përfundimtar për aplikimin e shoqërisë “SUNPOWER 2017” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); Shtojcën 1, Shtojcën 1A dhe Shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (Aneksi A).
- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, sipas përcaktimeve të Aneksit A të Rregullores.
- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “SUNPOWER 2017” sh.p.k. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3. gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 2.1, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.
- Për sa parashikuar në VNM-në Paraprake në lidhje me zbatimin në terren të projektit dhe duke iu referuar deklaratës së vetë shoqërisë se ajo ka bërë aplikimin përkatës për pajisje me leje ndërtimi nga Bashkia Fier dhe është në pritje të daljes së lejes, vlerësohet që, t’i lihet kusht shoqërisë që të informojë ERE-n çdo 4 (katër) muaj mbi ecurinë e punimeve të ndërtimit të centralit fotovoltaik, deri në datën 22.04.2024.
- ERE, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, por duke qenë se nga sa deklaruar nga shoqëria rezulton se jetëgjatësia e pritshme e centralit fotovoltaik është 25 vjet, atëherë ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit maksimal për këtë licencë fotovoltaike, deri në 25 vjet.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të licencojë shoqërinë “SUNPOWER 2017” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në Povelçë, Bashkia Fier, për një afat 25-vjeçar.
2. Shoqëria të informojë ERE-n çdo 4 (katër) muaj mbi fillimin e punimeve të ndërtimit të centralit fotovoltaik, deri në datën 22.04.2024.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

Votimi i bordit të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr. 73, Datë 13.03.2023

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “SUNPOWER 2017” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E  
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME  
KAPACITET TË INSTALUAR 2 MW, NË POVELÇË, BASHKIA FIER

Anëtarët e Bordit

Pro

Kundër

Petrit Ahmeti

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Maksim Shuli

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Raimonda Islamaj

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Petraç Lika

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Erjola Sadushi

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_